



Termet e Referencës

Hartimi i Udhëzuesit “Ofrimi i Mbështetjes Psikologjike dhe Ligjore për të Miturit-Viktima të Dhunës Seksuale në Procesin e Rehabilitimit, si dhe në fazat e Proceseve Hetuese dhe Gjyqësore”

Titulli i Punës: Konsulent për Hartimin e Udhëzuesit “Ofrimi i mbështetjes psikologjike dhe ligjore për të miturit-viktima të dhunës seksuale në procesin e rehabilitimit, si dhe në fazat e proceseve hetuese dhe gjyqësore”

Titulli i Projektit: Rehabilitimi dhe Riintegrimi i të Miturve - Viktima të Dhunës Seksuale, përmes ofrimit të Shërbimit të Rehabilitimit dhe Ndhmës Ligjore dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Institucioneve Shtetërore

Donatori: Fondi Kanadez për Iniciativa Lokale (CFLI), Ambasada Kanadeze për Kroaci dhe Kosovë

Përfituesit: Prokurorë dhe Gjyqtarë për të Mitur, Avokatë, Mbrojtës të Viktimave, Qendrat për Punë Sociale, Strehimoret, Policia e Kosovës, Personeli Shëndetësor.

Vendi i Projektit: Republika e Kosovës

Organizata Implementuese: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

Kohëzgjatja e Projektit: shtator 2023 – shkurt 2025

Për: Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

QKRMT është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar në eliminimin e dhunës dhe torturës. Mandati i saj është të mbrojë, avancojë dhe avokojë për të drejtat dhe lirinë themelore të mbijetuarve të torturës dhe formave të tjera të dhunës. QKRMT përpiqet të arrijë misionin e saj përmes rehabilitimit holistik, fuqizimit shoqëror-ekonomik, avokim ligjor për reforma ligjore dhe institucionale, ngritje të ndërgjegjësimit, ndërtimit të kapaciteteve, dhe realizimit të veprimtarive dokumentuese dhe hulumtuese.

Për më shumë informacion vizitoni: <https://krct.org/>

QKRMT, me mbështetjen e Ambasadës së Kanadasë për Kroaci dhe Kosovë, aktualisht po zbaton projektin “Rehabilitimi dhe Riintegrimi i të Miturve - Viktima të Dhunës Seksuale, përmes ofrimit të Shërbimit të Rehabilitimit dhe Ndhmës Ligjore dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Institucioneve Shtetërore (RECONNECT)”

Projekti RECONNECT synon të mbështesë të miturit - viktima të dhunës seksuale në Kosovë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Gjithashtu, projekti synon të fuqizojë një sistem interaktiv me shumë akterë që jo vetëm mbështet të miturit në shërimin, mirëqenien dhe ri-integrimin shoqëror, por gjithashtu kontribuon në parandalimin e dhunës seksuale kundër tyre.

Projekti përbëhet nga dy qëllime kryesore:

1. Të ndihmojë të miturit-viktima të dhunës seksuale në Kosovë për t'u rehabilituar dhe ri-integruar në shoqëri; dhe



2. Të fuqizojë një sistem ndërveprues shumë-akterësh, i cili jo vetëm që i ndihmon të miturit në shërimin, mirëqenien dhe ri-integrimin në shoqëri, por kontribuon në parandalimin e dhunës seksuale ndaj tyre.

Në kuadër të qëllimit të dytë projekti, thekson nevojën e domosdoshme për hartimin e një udhëzuesi të përgjithshëm duke përfshirë praktikave më të mira, procedurat dhe njohuritë mbi aspektet psikologjike për mbështetjen e të miturve-viktima të dhunës seksuale gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Objektivat e Hartimit të Udhëzuesit

Zhvillimi i udhëzuesit do të përqendrohet specifikisht në objektivat e mëposhtme:

1. Sintetizim i hulumtimeve ekzistuese, praktikave më të mira rajonale dhe kuadrit ligjor kombëtar për të krijuar një burim të përgjithshëm të përshtatur për kontekstin e Kosovës.
2. Elaborim i thelluar i Protokollit Shtetëror për Parandalimin e Dhunës Seksuale, legjislacionit kombëtar dhe dokumenteve ndërkombëtare të tjera të aplikueshme në Kosovë.
3. Qasja me në qendër viktimën/të mbijetuarin/en dhe parimet udhëheqëse që mbështesin punën ndihmuese gjatë procesit gjyqësor dhe të rehabilitimit tek të miturit viktima të dhunës seksuale.
4. Identifikimi i zbrazëtirave dhe/ose paqartësive në procesin e trajtimit të rasteve të dhunës seksuale kur të miturit janë viktima si dhe adresimi i sfidave me të cilat përballen prokurorët, gjyqtarët, avokatët, mbrojtësit e viktimave, policia, mjekësia ligjore, personeli shëndetësor dhe strehimoret, duke ofruar udhëzime praktike për të parandaluar ri-traumatizim gjatë proceseve ligjore.

Fokusi i Punës

Konsulenti në zhvillimin e udhëzuesit do të përqendrohet veçanërisht në detyrat e mëposhtme:

1. Rishikim të hollësishëm të literaturës relevante, praktikave më të mira rajonal/globale dhe kuadrove ligjore ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë.
2. Konsultime me palët përgjegjëse në ofrimin e shërbimeve gjatë trajtimit të rasteve, për të kuptuar sfidat dhe praktikave efektive lidhur me të miturit, viktima të dhunës seksuale, përmes aktiviteteve të organizuara gjatë projektit ose intervistave individuale me palët të organizuara nga konsulenti.
3. Përgatitja e një udhëzuesi të thjeshtë dhe praktik, duke përfshirë aspektet psikologjike dhe duke adresuar pasojat e dhunës seksuale në të miturit/at, duke siguruar një qasje të orientuar nga trauma dhe procedura ligjore miqësore ndaj të miturve.
4. Bashkëpunim i ngushtë me ekipin e projektit për të përfshirë komente në udhëzues.

Rezultatet e pritura

Pritet që konsulenti të dorëzojë:

1. Një draft të detajuar të udhëzuesit me fokus në: 1; legjislacionin kombëtar (me fokus në protokollin shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale); legjislacionit ndërkombëtar të



aplikueshëm në Kosovë; 2; Përfshirjen e Qasjes "me në qendër viktimën dhe parimet udhëheqëse që mbështesin punën ndihmuese gjatë procesit gjyqësor dhe të rehabilitimit tek të miturit viktimë të dhunës seksuale; 3. Identifikimi e zbrazëtirave dhe/ose paqartësive në protokollin shtetëror dhe procesin e trajtimit të rasteve të dhunës seksuale kur të miturit janë viktimë si dhe adresimi i sfidave me të cilat përballen prokurorët, gjyqtarët, avokatët, mbrojtësit e viktimave, policia, mjekësia ligjore, personeli shëndetësor dhe strehimoret, duke ofruar udhëzime praktike për të parandaluar ri-traumatizim gjatë proceseve ligjore; 4. Skemën e palëve të përfshira në proces sipas procedurave; 5. rekomandimet për palët përgjegjëse/plotësimin dhe ndryshimin e Protokollit Shtetëror.

Kohëzgjatja

Procesi i zhvillimit të udhëzuesit duhet të përfundojë në periudhën nga 18 dhjetor 2023 deri më 10 shkurt 2024.

Kualifikimet dhe Përvoja

Të paktën 5 vite përvoja të përgjithshme profesionale, në fushën juridike, psikologji apo një fushë të ngjashme.

Njohuri e thellë e kuadrove ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me dhunën seksuale ndaj të miturve.

Ekspertizë e dëshmuar në psikologjinë e fëmijëve, qasje të orientuara nga trauma, dhe kuadrot ligjore lidhur me të miturit.

Përvojë e demonstruar në zhvillimin e udhëzuesve ose materialeve trajnuese që ndërlidhin aspektin e psikologjisë dhe ligjit.

Bashkëpunimi dhe Komunikimi

Pritet që konsulenti të bashkëpunojë ngushtë me palët e interesuara të projektit dhe të sigurojë përditësime të rregullta për progresin dhe sfidat gjatë procesit të hartimit. Të jetë i disponueshëm për konsultime virtuale ose direkte sipas nevojës.

Buxheti

Ka një buxhet të caktuar për këtë shërbim të ofruar, duke përfshirë:

- Pagesë konkurruese në përputhje me ekspertizën dhe përvojën.

Kohëzgjatja

Aktivitetet e mësipërme duhet të përfundojnë në jo më shumë se 45 ditë kalendarike nga data e fillimit, në përputhje me këtë orar: 20 dhjetor 2023 – 2 shkurt 2024

25 dhjetor 2023 – dërgimi i abstraktit dhe metodologjisë për miratim

15 janar 2024 – drafti i parë final i udhëzuesit

29 janar 2024 – drafti final me komentet e përfshira

Dërgimi i Propozimit



Aplikimet duhet të dorëzohen deri më 18 dhjetor 2023 tek florida.gashi@krct.org Menaxhere e Projektit tek Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

Propozimi duhet të përfshijë:

- 1) CV të detajuar që thekson eksperiencën relevante.
- 2) Shembuj të punës së mëparshme në një fushë të ngjashme.

Ne vlerësojmë angazhimin tuaj në këtë çështje të rëndësishme. Nëse keni ndonjë pyetje ose nevojë për sqarime të mëtejshme, mos ngurroni të na kontaktoni.

